



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Nr. 29.

Prishtinë, më 10. shtator 2009, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I TAKIMIT TË MBAJTUR MË 10. 9. 2009

Morën pjesë: Bahri Hyseni - kryetar, Bajram Kosumi, Adem Hajdaraj, Adem Salihaj, Ramadan Gashi, Armend Zemaj, Ibrahim Makolli, Mufera Şinik dhe Kolë Berisha.

Munguan: Selvije Halimi dhe Vladimir Todorović

Të pranishëm: Rasim Rasimi – Gjykata Komunale e Gjilanit, Metije Ademi – MD Shërbimi Sprovues, Fillanza Kadriu – Gjykata e Qarkut të Prishtinës, Emine Kaçiku – Gjykata e Qarkut të Mitrovicës, Muamer Bikliqi – drejtor i QKL SHKK, Nebih Halili – Shërbimi Korrektues, Genc Nixha – Gjykata Komunale e Prizrenit, Yordan Sirov – EULEX, Charpenter Caroline – EULEX, Manir Shehu – OSBE, Denny Filkins – OSBE, Besnik Boletini – “Bota sot”, Rrezarta Ahmeti – KDI, Reshit Gashi - NDI dhe Visar Krasniqi – Zyra e Komisioneve të Kuvendit.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

Takimin e kryesoi: Bahri Hyseni - kryetar i Komisionit

R e n d i i d i t ë s

1. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit penal për të mitur

Kryetari – I përshëndeti përfaqësuesit e institucioneve, të cilët ishin të ftuar në takim për shqyrtimin e Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit penal për të mitur. Njoftoi se Komisioni, në vazhden e punëve të tij, e ka pasur në mbikëqyrje zbatimin e këtij ligji. Prandaj para se të dërgohet në Kuvend tha duam t'i marrim edhe rekomandimet tuaja, në mënyrë që të plotësohet ky raport. Lidhur me këtë pikë e hapi diskutimin.

Armend Zemaj – Duke u mbështetur në rekomandimin që i referohet mungesës së gjyqtarëve në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës, shtoi se nuk duhet të kufizohemi vetëm në Prishtinë. Tha se është domosdoshmëri që ky rekomandim të përgjithësohet përkitazi me rekomandimin për numrin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve.

Genc Nixha - E njoftoi Komisionin për gjendjen në Gjykatën Komunale të Prizrenit. Tha se numri i gjyqtarëve është shumë i vogël. Theksoi se është i vetmi gjyqtar për të mitur në Gjykatën Komunale të Prizrenit, në të cilën përfshihen Malisheva, Dragashi dhe Rahoveci. Rekomandoi që në secilën gjykatë komunale të jetë nga një gjyqtar për të mitur.

Metije Ademi - E njoftoi Komisionin për funksionimin e Shërbimit Sprovues të Kosovës. Shtoi se në rekomandimet që janë pjesë e Raportit pak i është dhënë rëndësi këtij institucioni. Ceku se ajo që po e pengon Shërbimin Sprovues në efektivitetin e punës së tij është ngritja e kapaciteteve që nga infrastruktura dhe nevoja e organizimit të zyrtarëve të specializuar për të mitur. Propozoi që masën e ndërmjetësimit dhe të këshillimit psikologjik ta zbatojë Shërbimi Sprovues i Kosovës.

Emine Kaqiku - Lidhur me përfundimin nr. 2 të Raportit rekomandoi të parashihet mundësia e ndarjes së mjeteve buxhetore për familjet që marrin në mbikëqyrje fëmijë, sepse është një stimulim për to.

Ibrahim Makolli - U pajtua me parafolësit se ka mungesë të gjyqtarëve, mirëpo shtoi se ligji parasheh edhe institucione, të cilat as sot nuk janë krijuar. Edhe po të kishte mjaft gjyqtarë, problem do të ishte funksionimi i tyre, sepse ka mungesë të institucioneve. Në fjalën e tij përmendi edhe shkeljet që janë evidencuar me rastin e vizitës në institucionet që ekzistojnë.

Adem Hajdaraj – Propozoi që rekomandimi nr. 7 të riformulohet si vijon: “Të shtohet numri i gjyqtarëve dhe i prokurorëve të specializuar për të mitur.”

Fllanza Kadiu - Rekomandoi që ky komision të kërkojë nga Qeveria e Republikës së Kosovës mjete financiare për themelimin e institucioneve të cilat i parasheh ligji. Shtoi se është e nevojshme të ketë institucion edukimi dhe qendra disiplinore. Propozoi që numri i gjyqtarëve për të mitur në gjykatat komunale të jetë në përpjesëtim me numrin e banorëve.

Muamer Bikliqi - Përmendi mungesën e stafit si problem me të cilin ballafaqohet Qendra Edukative Korrektuese e Lipjanit.

Adem Salihaj - I falënderoi përfaqësuesit e institucioneve. Shtoi se mirëpritën me shkrim rekomandimet tuaja, që ato të jenë pjesë e Raportit. Kërkoj t'i kushtohet vëmendje Shërbimit Sprovues. Vuri në pah se ka nevojë për analiza

lidhur me efektin e dënimeve, në mënyrë që të bëjmë krahasime dhe Shërbimit Sprovues t'i japim rëndësi më të madhe. Po ashtu përmendi edhe ngritjen e nivelit profesional të gjyqtarëve, si nevojë që duhet të kihet parasysh.

Bajram Kosumi - Kërkoj nga Komisioni saktësi në rekomandime, sepse ato janë obligative për Qeverinë. Në fjalën e tij përmendi dy çështje të cilave Komisioni duhet t'u kushtojë vëmendje. *E para* Qendra Edukative në Lipjan është burg në kuptim të plotë të fjalës, e jo qendër edukative ashtu siç është përkufizuar në ligj dhe *e dyta* problemet që kanë të bëjnë me mosshfrytëzimin e pushimeve në shtëpi të të dënuarve, që parashihen me ligj, por nuk zbatohen.

Pas debatit Komisioni nxori këto

R e k o m a n d i m e

1. Të nxirren të gjitha aktet nënligjore për zbatimin e Ligjit penal për të mitur (neni 155).
2. Të miratohen rregullat për rendin e brendshëm në institucionet korrektuese (neni 196.2) LESP-it.
3. Të miratohen rregullat për rendin e brendshëm në Shërbimin Sprovues të Kosovës.
4. Të ngrihet efektiviteti i dorëzimit-pranimit të shkresave nga gjykatat te personat e dënuar, me theks të veçantë të atyre shkresave që dërgohen me postë.
5. Të rriten kapacitetet ekzistuese të kujdesit-trajtimin shëndetësor në Qendrën Edukative Korrektuese të Lipjanit.
6. Të themelohen institucione të parapara me Ligjin penal për të mitur.
7. Të shtohet numri i gjyqtarëve dhe i prokurorëve të specializuar për të mitur.
8. Të ndahet Qendra Edukative – Korrektuese e Lipjanit nga Burgu për të mitur, në të cilin statusi i Qendrës të jetë ashtu siç është paraparë me ligj.
9. Të ngrihen kapacitete njerëzore dhe infrastruktura për Shërbimin Sprovues të Kosovës.
10. I rekomandohet Qeverisë së Republikës së Kosovës – Ministrisë së Punëve të Brendshme, që në kuadër të Policisë së Kosovës të krijojë njësit të specializuar për punë me të mitur.
11. Të fillohet procedura për ndryshimet dhe për plotësimet e Ligjit penal për të mitur, të atyre dispozitave që pengojnë zbatimin efektiv të LPM-së.
12. Ministria e Drejtësisë t'i raportojë Komisionit 6 muaj pasi t'i ketë marrë këto rekomandime.

Procesverbali u hartua nga stafi Mbështes i Komisionit.

Kryetari i Komisionit
Bahri Hyseni
